



30-03-2017

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretar@kqz-ks.org www.kqz-ks.org

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 272-2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2013 për Zëvendësimin e Anëtarëve të Kuvendeve Komunale, më 30.03.2017, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **TEUTA BERISHA** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Obiliq, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës -LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **znj.Xhyljeta Ibrahim**.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Obiliq, që ky vendim t'i komunikohet **znj.Teuta Berisha**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Obiliq të datës 15.03.2017, Nr.234/2017, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit znj. Xhyljeta Ibrahim, pas dorëheqjes së saj të parë nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës. Duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatës të radhës sipas listës së rirenditur, e cila është znj. Teuta Berisha, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 30.03.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2013 për Zëvendësimin e Anëtarëve të Kuvendeve Komunale, më 30.03.2017, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z.LULZIM ABAZI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës -PDK” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Lulzim Aliu**.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Ferizaj, që ky vendim t’i komunikohet **z.Lulzim Aliut**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Ferizaj, të datës 16.03.2017, Nr.235/2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Lulzim Aliu, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z.Lulzim Abazi, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 30.03.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





30-03-2017

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretarijati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Prishtinë / Priština  
Nr.1Br. 270 - 2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 paragrafi (b) të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 3 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, më 30.03.2017, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z.MUSA FAZLIU** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës -PDK” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **znj.Ardita Nura**.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Skenderaj, që ky vendim t’i komunikohet **z.Musa Fazliut**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Skenderaj, të datës 20.03.2017, Nr 243/2017 për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit komunal znj.Ardita Nura, pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga kjo pozitë.

Duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, cili është z.Musa Fazliu, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së kundërt pasi që në listën e rirenditur nuk ka pasur kandidatë të gjinisë së njëjtë të atij subjekti, dhe me numër më të madh të votave, si dhe bazuar në rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 30.03.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

